

# Duhanpirësit konsumojnë më pak cigare kur cigaret janë më pak të përballueshme

## Gjetjet kryesore:



Mesatarisht, ulja prej një përqind në përballueshmërinë e cigareve rezulton në ulje prej tre përqind në konsumin e duhanit në Kosovë.



Rezultatet e studimit demonstrojnë ndikimin e përballueshmërisë në konsumin e duhanit në Kosovë; ulja e përballueshmërisë do të ulë konsumin e duhanit.



Faktorët që shpjegojnë variacionin në konsumin e cigareve në Kosovë përfshijnë punësimin, statusin civil dhe nivelin e arsimit. Gjetjet tregojnë se individët që janë të martuar, ata të punësuar dhe ata me arsim të mesëm kanë prirje të shfaqin nivele më të larta të konsumit të cigares në krahasim me homologët e tyre.

## Background

Në vitin 2019, prevalenca e pirjes së duhanit te të rriturit e moshës 18 deri në 85 vjeç në Kosovë ishte 36.4 për qind (Tabela 1). Kostoja mesatare për pako me 20 cigare, e treguar në Tabelën 2, ishte relativisht e ulët, me çmime më pak se 2 euro. Figura 1 vë në pah se duhanpirësit në Kosovë shpenzojnë mesatarisht 80 euro në muaj për duhan. Për më tepër, Figura 2 tregon se pagat në tre sektorë kanë treguar trend të qëndrueshëm rritës gjatë 10 viteve të fundit.

Përveç pasojave të dëmshme për shëndetin, konsumi i duhanit pengon edhe zhvillimin ekonomik të një kombi përmes imponimit të kostove financiare dhe shëndetësore. Nisur nga ky fakt, prevalenca e lartë e pirjes së duhanit në Kosovë, si një nga vendet më të varfra të Evropës, është veçanërisht shqetësuese.

Rritja e akcizës së duhanit është dëshmuar si masë shumë efektive për kontrollin e duhanit. Megjithatë, në mënyrë që taksa të veprojë për të dekurajuar konsumin e duhanit, ndikimi i saj duhet të balancohet me efektet e rritjes së të ardhurave. Kjo kërkon patjetër që çmimet e duhanit të cilat rezultojnë nga rritja e taksave të rriten me një ritëm më të shpejtë sesa të ardhurat reale.

Rrjedhimisht, përballueshmëria ose çmimi i produkteve të duhanit në raport me të ardhurat konsiderohet si faktor kyç që ndikon në konsumin e duhanit. Gjithashtu përdoret gjerësisht si indeks për matjen e progresit në tatimin e duhanit në vendet me të ardhura të ulëta, ku konsumi i madh i duhanit shpesh ndodh me taksa më të ulëta sesa në vendet me të ardhura të larta. Duhanpirësit konsumojnë mesatarisht 160 cigare (tetë pako) në javë (Figura 3), konsum ky që do të mund të ulej me uljen e përballueshmërisë së cigareve, siç tregohet në Figurën 4.

**Tabela 1****Përdorimi i duhanit**


	Në përgjithësi (%)	Meshkuj (%)	Femra (%)
Duhanpirës aktual	36.4	48.9	23.8
Duhanpirës që konsumon cigare në baza ditore	34.4	47.0	21.7
Numri mesatar i cigareve të konsumuara në ditë	20.7	23.6	14.7

Burimi: STC-SEE, 2019


**Tabela 2****Çmimet mesatare për pako të cigareve**

	Në përgjithësi (%)
Çmimi mesatar për pako të cigareve të prodhuara me 20 cigare	1.98
Çmimi mesatar për cigare të mbështjella me dorë	1.49

Burimi: STC-SEE, 2019

**Figura 1****Shpenzimet mujore për cigare**

Burimi: STC-SEE, 2019

**Figura 2****Niveli mesatar i pagës neto (në euro), 2012–2021**

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

## Metodologjia

Masat e përbalueshmërisë së vlerave të njësisë, të ardhurat e disponueshme të ekonomive familjare dhe çmimet janë konstruktuar duke përdorur të dhënat e Anketës mbi Konsumin e Duhanit në Evropën Juglindore (shkurt STC-SEE, nga gjuha angleze Survey on Tobacco Consumption in Southeastern Europe) dhe të Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjeve (shkurt HBS, nga gjuha angleze Household Budget Survey). Janë krijuar variabla të ndryshme për konsumin e cigareve duke përdorur numrin e cigareve të konsumuara në ditë, të raportuara nga respondentët e anketës dhe HBS.

## Results

Rezultatet e studimit sugjerojnë se përbalueshmëria më e ulët lidhet me konsumin më të ulët të duhanit në Kosovë. Ulja prej një përqind në përbalueshmërinë e cigareve shoqërohet me ulje prej tre përqind të konsumit, mesatarisht.

Mosha është gjithashtu faktor i rëndësishëm në konsumin e cigareve, ku rritja prej një viti të moshës çon në rritje mesatare të konsumit prej 0.02 përqind.

Gjinia është gjithashtu parashikues i rëndësishëm, me meshkujt në Kosovë që konsumojnë mesatarisht rreth 38 përqind më shumë sesa femrat.

Punësimi dhe statusi civil duket se shpjegojnë disa variacione në konsum, ku individët e punësuar konsumojnë rreth katër përqind më shumë sesa të papunët dhe individët e martuar që konsumojnë mesatarisht rreth 0.5 përqind më shumë sesa të pamartuarit.

Niveli i arsimimit është gjithashtu faktor i rëndësishëm. Ata me arsim të mesëm konsumojnë rreth gjashtë përqind më shumë sesa ata me vetëm nivele fillore ose më të ulëta, ndërsa ata me arsim të lartë konsumojnë rreth gjashtë përqind më pak.

Intensiteti i konsumit ndryshon sipas rajoneve, ku banorët e zonave urbane konsumojnë mesatarisht rreth 0.7 përqind më pak sesa ata në zonat rurale.

Variablat e kontrollit sipas komunave janë gjithashtu domethënëse, ku banorët e Gjilanit konsumojnë rreth nëntë përqind më shumë sesa ata të Ferizajt dhe banorët e Mitrovicës rreth dy përqind më shumë sesa ata të Ferizajt. Banorët e Prishtinës, Pejës dhe Prizrenit konsumojnë më pak sesa ata të Ferizajt.

Figura 3

### Konsumi javor i cigareve për duhanpirës





Figura 4

### Përbalueshmëria e cigareve



## Rekomandime në nivel të politikave

### Rritje e ndjeshme e çmimit:

Duke pasur parasysh kufizimet e kalendarit të akcizës së duhanit që funksionon nën supozimin e faktorëve fiks dhe aplikon vetëm një rritje të vogël dhe të sheshtë të akcizës çdo vit, qeveria do të duhej të adoptojë qasje proaktive në nivel të politikave që merr parasysh luhatjet në të ardhurat e ekonomive familjare dhe të individëve, me qëllim uljen e përballueshmërisë së cigareve në mënyrë të vazhdueshme dhe të ndjeshme.

### Alokimi i të hyrave tatimore shtesë:

Të hyrat shtesë të gjeneruara nga rritja e akcizës së duhanit duhet t'i alokohen Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Arsimit për të financuar programe që synojnë promovimin e zhvillimit të kapitalit njerëzor, që ka të ngjarë të sjellë rritje të konsiderueshme ekonomike shtesë. Këto programe mund të përfshijnë, dhe jo vetëm, nisma me qëllim përmirësimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, avokimin për përfitimet nga lënia e duhanit dhe edukimin e publikut mbi rreziqet dhe efektet e dëmshme të përdorimit të duhanit.

### Falënderime:

Democraci Plus financohet nga Instituti për Kërkime dhe Politika Shëndetësore i Universitetit të Illinois në Çikago (UIC) për të kryer kërkime ekonomike mbi tatimin e duhanit në Kosovë. UIC është partner i Nismës së Bloomberg për Filantropi për të reduktuar përdorimin e duhanit. Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument nuk mund t'i atribuohen dhe as nuk mund të konsiderohen se përfaqësojnë pikëpamje të UIC, Institutit për Kërkime dhe Politika Shëndetësore, ose Nismës së Bloomberg për Filantropi.